



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Viti

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 08/L-197 neni 37, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 dhe Rregullorës (QRK) Nr.03/2024 për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për periudhë të caktuar, neni 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, neni 7 paragrafi 1 dhe 3, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë shpall:

KONKURS PUBLIK

Nr.	Komuna Viti	Pozita	Vendi i lirë-kohëzgjatja	Numri i pozitave	Paga Koefficienti
1	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	Zyrtar Ligjor	Me afat të caktuar	1	GJ37 - 4.9
2	Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	Zyrtar Ligjor	Me afat të caktuar	1	GJ37 - 4.9

Përshkrimi i përgjithshëm i punës – Zyrtar Ligjor.

- Harton akte normative si dhe akte tjera juridike të cilat dalin nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim sipas legjislacionit në fuqi;
- Siguron përputhshmërinë e projektakteve dhe akteve tjera nënligjore me legjislacionin në fuqi në Kosovë;
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identik në gjuhët zyrtare;
- Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose qështjet për shqyrtim;
- Sipas kërkesës ose udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bënë hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera;
- Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërliken me fushën e legjislacionit;
- Merr pjesë në grupe punuese/komisione për hartim të akteve nënligjore.
- Kryen edhe punë të tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara sipas ligjit dhe Rregullorës QRK 03/2024.

Kërkesat e përgjithshme formale.

Arsimimi i kërkuar : për pozitën **Zyrtar Ligjor:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve: Fakultetin Juridik.

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitave të lira të punës

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetë së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit :

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

Afati dhe mënyra e aplikimit: Konkursi mbetet i hapur nga data 22.03.2024 deri më 28.03.2024.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në zyrën e Arkivës të Komunës së Vitisë, kati përdhësë në ndërtesën e Administratës së Komunës së Vitisë dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Arkivës apo të dërgohet me postë në këtë adresë: Komuna e Vitisë, Rr. Hasan Kabashi, pa nr. Viti. Rezultatet shpallen web faqen <https://kk.rks-gov.net/viti/category/konkursej-njoftimet/konkurset/>.

Kandidatët aplikantë të cilët kanë konkurruar, i njoftojmë se pas mbylljes së konkursit do t'i nënshtrohen vlerësimit nga intervista dhe vlerësimi i jetëshkrimit.

Më datë 22.03.2024

Udhëheqësi i NjMBNj
Hysen Ymeri

